

THIRRJE PËR MARSHIN PËRKUJTIMOR DHE PROTESTUES PËR VIKTIMAT QË HUMBËN JETËN NË TRAFIK NË KOSOVË

E diela e tretë e muajit Nëntor shënon Ditën Botërore të përkujtimit të viktimave në trafikun rrugor. Kjo ditë shënohet me qëllim të përkujtimit të miliona njerëzve që humbin jetën në aksidentet rrugore, por njëkohësisht edhe për mbështetje ndaj familjarëve të viktimave.

Në Kosovë këtë ditë përkujtimore do ta shënojmë për të kujtuar 106 jetërat e humbura, por edhe për të protestuar dhe thirrur për siguri më të madhe në rrugë.

Ju lutem, gjeni me poshtë agjendën e aktiviteteve të planifikuara sipas ditëve:

E enjte, datë 12 Nëntor 2015, lansimi i aktiviteteve javore për shënimin e Ditës Botërore kushtuar viktimave në rrugë, KTV ora 09:30-10:00.

E premte, datë 13 Nëntor 2015, dhurimi i gjakut dedikuar personave të lënduar në aksidente në trafik, Kolegji Tempulli, ora 10:00.

E shtunë, datë 14 Nëntor 2015, prezantimi i spoteve-filmave për vetëdijesimin e pjesëmarrësve në trafik. Sheshi "Zahir Pajaziti", ora 18:00 deri 21:00.

E diele, datë 15 Nëntor 2015

Ora 12:00 – Marshi protestues (ecje në këmbë) nga Sheshi "Zahir Pajaziti" deri te Teatri Kombëtar.

Ora 13:00 – Marshi protestues me biçikleta, nisja nga Pallati i Rinisë (New Born), deri te rrethi në Fushë Kosovë dhe kthimi deri te ndërtesa e Komunës së Prishtinës (ku do të protestohet 15 minuta). Përfundimi i marshit sërish te Pallati i Rinisë.

Ora 18:00 Ndezja e 106 qirinjëve para Teatrit Kombëtar, në nderim të viktimave të cilët kanë humbur jetën në Kosovë në periudhën Janar-Tetor 2015.

Është koha e fundit për veprim të menjëhershëm për të ju thënë stop krimeve në rrugë!!!



ËSHTË KOHA PËR TË KUJTUAR - THUAJ 10 KRIMEVE NË RRUGË